



**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"2B 1979" SHPK**

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Sot, në datën 07.03.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) unë :

Bledar BROSHKA, atësia Bajram, amesia Tushe, i datelindjes 03/04/1979, lindur ne Fier, banues ne Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal H90403155N,

në cilësinë e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", vendosa të themelojë shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emërtimin **"2B 1979" SHPK.**

KREU I

EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

Neni 1

EMRI I SHOQËRISË

1. Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuara do te jete: **"2B 1979"** (me poshte do te quhet **shoqeria**)
2. Shoqeria **"2B 1979"** është person juridik, e cila fiton personalitet juridik në datën e regjistrimit në QKB.

Neni 2

SELIA

1. Selia e shoqerise ndodhet në adresën: Rruga "Isail Qemali", 34, Hyrja 1, Kati 1, Tiranë, adresë e cila mund të ndryshohet nëvarësi të zgjerimit dhe kushteve te krijuara.
2. Shoqeria mund ta shtriye aktivitetin e saj me zyra apo degë në të gjithë territorin e Republikes se Shqipërisë dhe jashte saj.

Neni 3

KOHEZGJATJA

Shoqëria **"2B 1979" SH.P.K.** do ta ushtrojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEQENDRORE
Neni 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

1. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në baze të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Veprimtari në fushën e ndërtimit si studimi, projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave publike, civile, private, rrugëve, urave, traseve hekurudhore, veprave bonifikuese e ujore, veprave të artit, centraleve, objekteve turistike, të kultit, hidrocentraleve, ujesjelles, porte, ndërtesa industriale dhe realizimi i studimeve urbane, sistemeve hidraulike dhe hidrosanitare, teknologjike, ndertime civile, industriale, ekonomike, teknologjike, energjitike, si dhe të gjitha restaurimet dhe rikonstruksionet në përgjithësi, ndertime të veprave të ndryshme, përfshirë kanalizimet dhe ujesjellesat, vepra kullimi, ujitje të tokës dhe impiante vaditëse etj;

- Ndërtim, montim dhe rikonstruksion i objekteve dhe veprave të çfaredollojshme, industriale, turistike, civile. Asflitim rrugësh, punime bonifikimi. Prodhim i materialeve të ndërtimit si dhe transport i tyre.

- Studim, projektim, prodhim, montim, tregtim dhe zbatim i sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale, ndricuese dhe jondricuese, vijezime, barriera rrugore etj;

- Import-eksport dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave ushqimore pa kufizim të çdo lloji, artikujve makinerive, industriale, impianteve, mjeteve makinerive, pjesëve të këmbimit, elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, mekanike, kompjuterike, hidrosanitare, hidraulike, qeramike, qelqi, artizanati, duralumini, lendeve të para, lendeve të ndërtimit, pllakave të lëndës drusore të përpunuar dhe papërpunuar, mobiljeve, kancelarise, bojërave, aparturave kopjuterike dhe dixhitale, materialeve të lëndës të para të të gjitha llojeve, materialeve të lëndës plastike, gome, hekuri, kimike e nënprodukte të tyre, linjash e makinerish në fushën e prodhimit, përpunimit, transportit, ndërtimit, serviseve, artikujsh e produktesh ushqimore, buqësore, blegtorale si dhe çdo lloji malli tjetër pa kufizim, të pacituar me lartë. Në fushën e ndërtimit në përgjithësi dhe në vecanti në fushën e ndërtimit të rrugëve, autostradave, urave, tuneleve, minierave, hidrocentraleve, ujesjellsave, rikonstisione, mirembajtje. Në fushën e transportit me mjetet e vetë shoqërisë ose për llogari të të tjerëve. Në fushën e dhenies dhe marrjes me qira të mjeteve dhe makinerive në fushën e ndërtimit.

- Import export i pijeve alkoolike, verërave, likernave të çdo lloji pijeje tjetër pa kufizim, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë gjithashtu:

- Shitblerje dhe dhënie me qira e pasurive të paluajtshme;

Gjithashtu shoqëria mund të ushtrojë edhe çdo lloji aktiviteti tjetër të pashprehur me sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

- Shoqëria mund të marrë pjesë në menyre të drejtpërdrejta ose të terthorte në çdo shoqëri që ka objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e shoqërisë.

2. Shoqëria, për realizimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimeve të saj mund të angazhohet në çfaredo lloji aktiviteti tjetër që nuk ndalohej me ligj.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 1 Kapitali i regjistruar i shoqërise është ALL 100,000 (njëqindmijë lekë), i barabartë me 1 (një) kuotë. Kontributet e ortakëve përbejnë kapitalin e regjistruar të shoqërise.
- 2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotës të secilit ortak, llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur në mënyrë të përbledhur sipas grafikut të mëposhtem:

Nr.	Emri i Ortakëve	Kuota	Kontributi i ortakëve në kapital (leke)	Përqindja në kapital
1.	Bledar Broshka	1	100.000	100%
Totali		1	100.000	100 %

- 3 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakut të vetëm të shoqërise.

Neni 6

SHITJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

1. Asnjë nga ortakët e shoqërise nuk mund të transferojë kuotat përkatëse të pjesëmarrjes në shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Mënyra e ushtrimit të të drejtës së parablerjes do të përcaktohet në marrëveshjen e firmosur nga ortakët e shoqërise.
2. Lejohet shitja ose transferimi plotësisht ose pjesërisht i kuotave të një ortaku tek një shoqëri tjetër e kontrolluar nga ky ortak.
3. Në rast zmadhimi apo zvogelimi të kapitalit themeltar të shoqërise, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit ose zvogelimit të kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zoteron secili në kapitalin e shoqërise në atë datë.

Neni 7

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjesës së kapitalit që zoterojnë.

KREU III ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 7 ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqerise i cili miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve është pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a)Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b)Ndryshimet e statutit
- c)Emerimin dhe shkarkimin e administratorit
- ç)Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te miratuar
- d)Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) dhe ç) te ketij neni
- dh)Mbikqyrjen e zbatimit te politikave trgtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore si edhe te raporteve periodike te ecurise se veprimtarise.
- e)Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve periodike te ecurise se veprimtarise
- ë)Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar
- f)Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g)Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administratorve
- gj)Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h)Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te shoqerise
- i)Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër ose nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne mbledhjen e asamblese. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 8 MENYRA E THIRJES SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE



Asambleja e ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nepermjet postes elektronike ne nje adrese te konfirmuar. Njoftimi me shkrese ose elektronik duhet te permbaje, vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites. Njoftimi duhet tu dergohet ortakeve jo me vone se 7 dite para dates se caktuar per zhvillimin e mbledhjes.

Nese asambleja nuk eshte thirrur sipas paragrafit te pare te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort pavaresisht parregullsive.

Neni 9 KUORUMI

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Cdo kuote eshte e barazvlefshme me nje vote. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi.

Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Përveç kur parashikohet ndryshe ne kete statut votimi zhvillohet si me poshte:

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese marrin pjese ne mbledhje ortaket me te drejte vote qe zoterojne te pakten 30% te kuotave te kapitalit themeltar.

Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas neni 87 te ligjit "per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave marrin pjese personalisht ose me perfaqesues, votojne me shkrese ose me mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes tre te nenit 88 te ligjit "per tregtaret dhe shoqerite tregtare".


Nese asambleja e ortakeve nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 10 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e ortakeve vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres ne mbledhje, per ndryshimet e statutit, per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja vendos me shumicen e thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres per ceshtje te tjera si:

a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise

- 
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te miratuar
 - ç) Percaktimin e shperblimeve
 - d) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave trgtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore si edhe te raporteve periodike te ecurise se veprimtarise.
 - dh) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve periodike te ecurise se veprimtarise
 - e) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj administratorve
 - f) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te shoqerise

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Kryetari i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te jete administratori i shoqerise i cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e pergjithshme ne cdo mbledhje te saj do te emeruje me shumice te thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres edhe nje person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.

Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Neni 11

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e ortakeve vendos per:
 - Vleresimin e veprimtarise se tij
 - Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
 - Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria
 - Dhenien ose jo te perfitimeve te reja
2. Kur ortaku perfaqesohet nga ndonje perfaqesues i autorizuar, perfaqesuesi vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku te cilin perfaqeson.

Neni 12

ADMINISTRIMI

Asambleja e ortakeve emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte nje vit, me te drejte riemerimi. Emerimi i administratoreve prodhon efektet pas rregjistrimit ne QKB.

Nuk mund te caktohen si administratore te kesaj shoqerie administratore te shoqerive meme te saj nese do te kete ne te ardhmen.

Personi i meposhtem do te caktohet si administrator i pare i shoqerise deri ne emerimin e tij ne mbledhje e pare te asamblese se ortakeve.




Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. **Bledar BROSHKA**, atesia Bajram, amesia Tushe, i datelindjes 03/04/1979, lindur ne Fier, banues ne Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal H90403155N.

Neni 13 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar ne fuqi.

Pa u kufizuar sa me sipër, ne menyre te vecante, Administratori ka keto kompetenca:

- (i) do te drejtoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;
- (ii) do te nenshkruaje cdo marreveshje ne emer te Shoqerise;
- (iii) do te hape llogari ne emer te Shoqerise me cdo banke qe kryen aktivitet ne Shqiperi ose jashte saj,
- (iv) do te pergatise te gjitha planet per marrjen e financimeve, do te nenshkruaje cdo kontrate huaje apo kontrate tjeter qe parashikon nje borxh apo borxh te mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijojte nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuar shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Ortakeve te marre me shumice te kualifikuar;
- (v) do te urdheroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoqerise - duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (vi) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- (vii) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Ortakeve;
- (viii) do te krijojte nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

- 
- (x) do t'i raportoje Asamblese se Ortakeve per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
 - (xii) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
 - (xi) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Ortakeve.
 - (xii) Do te administroje adresat dhe kontaktet e ortakeve (tel, email). Ne cdo rast ortaket jane te detyruar qe menjehere pas cdo azhornimi te kontakteve te tij (nr.tel, email, adrese shtepie) te njoftoje administratorin me shkrim, ne te kundert mban pergjegjesi per cdo dem te shkaktuar nga mosnjoftimi ne kohe.

Administratoret jane te detyruar qe te therrasin mbledhjen e asamblese ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor te shoqerise ose raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise te mos mbulojne dot detyrimet e kerkueshme brenda tre muajve ne vazhdim
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter, aktive qe kane nje vlere prej te pakten 10% te aseteve totale te shoqerise, sic rezulton nga pasqyrat me te fundit financiare te certifikuara
- Shoqeria propozon te bleje pasuri qe kane nje vlere me te madhe se 10% te aseteve totale te shoqerise, sic rezulton nga pasqyrat me te fundit financiare te certifikuara.

Asambleja e ortakeve, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa me sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 14

KUFIZIMET E ADMINISTRATORIT

Administratori nuk do të lidh marrëveshje dhe nuk do te kryeje veprime juridike, për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit per



shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja se Ortakeve te shoqërisë, ne baze te kuorumit te kerkuar, autorizon lidhjen e kësaj marrëveshje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 15

DETYRIMET DHE PERGJEGJESIA E ADMINISTRATORIT

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme ligjore të detyrimit të besnikërisë, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me

ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë ortakëve kontributet;

b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare,

duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
d) japin kredi.

Neni 16 **TE NDRYSHME**

Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.

Te gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.

Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.

Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së Ortakëve.

Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

Neni 17 **DISPOZITA TE FUNDIT**

Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilesuar të percaktuar me sipër.


Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do të referohen legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.


Ky Statut përpilohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga themeluesit e shoqërisë.

Një kopje depozitohet në zyrën noteriale para së cilës edhe u nënshkrua, kopjet e tjera i jepen themeluesve.

THEMELUESI

Bledar BROSHKA

Bledar BROSHKA




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 1202 Rep.
Nr. 565 Kol.

VERTETIM NËNSHKRIMI

Në Tiranë, sot në datën 7 Mars 2019 (dymije e nentembdhjete), përpara meje Ermal Xh. Hamzaj, Noter, Anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me adresë zyre: Rruga "Ismail Qemali", Nd. 4, H. 1, Njesia Bashkiake Nr. 5, u paraqit personalisht:

Z. **Bledar BROSHKA**, atesia Bajram, amesia Tushe, i datelindjes 03/04/1979, lindur ne Fier, banues ne Tiranë, madhor, me zotesi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal H90403155N, i deklaroi perpara meje noterit se me vullnet te lire, te plote dhe te pavesuar ka hartuar në cilësinë e ortakut themelues Akt Themelimi dhe Statutin e shoqerise ne themelim e sipër "**2B 1979**" SHPK të datës 07/03/2019 si dhe e nenshkroi atë personalisht në praninë time, noterit.

Sa më sipër, unë Noteri vërtetoj autenticitetin e nënshkrimeve të bëra nga personi i mësipërm në aktet e hartuara prej tij, me cilësinë që më njeh neni 55 i Ligjit nr. 7829, date 01.06.1994 " Për Noterinë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).





REPUBLICAN PARTY
CHARITABLE CONTRIBUTION
NO. 123456
DATE 12/31/2023

CONTRIBUTION STATEMENT

This document is a contribution statement for the year 2023. It is provided for your records and is not a receipt for the contribution. The contribution was made to the Republican Party, a 501(c)(3) organization.

The contribution was made in the form of cash. The amount of the contribution was \$1,000.00. The contribution was made on 12/15/2023. The contribution was made by Mr. John Doe, 123 Main Street, Anytown, NY 12345. The contribution was made for the purpose of supporting the Republican Party's activities.

This contribution is not tax-deductible. The contribution is not eligible for a charitable deduction under Section 170(e)(2)(B) of the Internal Revenue Code. The contribution is not eligible for a charitable deduction under Section 170(e)(2)(C) of the Internal Revenue Code.

